



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## KUVENDI I KOMUNËS

### KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

01. Nr. 06-4699/17

KLINË, 17.7.2017

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I SEANCËS SË KPF VII-të, MBAJTUR, MË 17.7.2017, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KPF-së, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, Drejtori i Drejtorisë së FEZH, Ramiz Rrusta, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi, Morina, përfaq. të KFORI-it, përfaq. të OSBE-së, OJQ “Koha”, etj.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit kryesuesi i KPF-së, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroi mirëseardhje në këtë seancë të KPF-së. Kryesuesi kërkoi që në pikat e rendit të ditës të përfshihet edhe një kërkesë e kryetarit, Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për vitin 2016.

Kryesuesi në vijim arsyatoi kërkesën e kryetarit, në mënyrë që raporti i Auditimit për vitin 2016 të përfshihet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Kryesuesi hapi debatin rreth çështjes bosht.

**Fadil Gashi**, tha se nuk keni pasur qare pa e përfshirë si pikë e rendit të ditës, sepse e keni për obligim. “Është mirë se po hyn në rend të ditës, megjithatë ne e kemi një rregullore mirëpo nuk e kemi kopjen fizike”, pohoi ndër të tjera anëtarri Gashi. “Është vetëm dhënia e dritës së gjelbër për diskutim publik. Zyra ligjore është duke e përpunuuar këtë rregullore”, sqaroi kryesuesi.

**Fadil Gashi**, tha se mos na qitni në pozitë të keqe, proceduralisht nuk është në rregull. Ne nuk dimë çfarë të miratojmë, nuk kemi asgjë përpëra.

**Halil Desku**, tha se nëse vërtet nuk shkelim në ligj, të procedojmë. “Rregullorja është shumë e rëndësishme. Të mos humbim kohë, do të na vije prapë për shqyrtim”, tha prof. Desku.

**Fadil Gashi**, tha se të na mirëkuptoni, sot nuk kemi draft, përpara nuk kemi asgjë, nuk mund të marrim përgjegjësinë.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi disa gjera rreth çështjes në debat.

**Ramush Agushi**, tha se përpara nuk kemi asnje dokument, po që se nuk na vjen në seancën e KK të mos vihet në shqyrtim.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës me plotësimin.

**Me 4 vota për 3 kundër u miratua ky**

#### **RENDIT TË DITËS**

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të Menaxhimit Financiar të Komunës për periudhën janar – qershor 2017,
4. Shqyrtimi i Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së Tatimit në pronën e Paluajtshme,
5. Shqyrtimi i propozimit për vënien në diskutim publik të Projekt-rregullores për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre,
6. Shqyrtimi i procesverbalit të takimit të parë me qytetarë për vitin 2017,
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Komunës për vitin 2017,
8. Të ndryshme.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa të anëtarëve.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit.

**Ndue Shabanaj**, pati vërejtje rreth procesverbalit të seancës së kaluar. “Mund të jenë edhe lëshime teknike. Në fq. 3 ku shkruan. “Këtë material e morash tash, mundit tona janë tepër të kufizuara për të debatuar”. Duhet përmirësuar fjalinë dhe duhet të jetë “Këtë material e mora tash dhe mundësitet tona janë tepër të kufizuara për debat”. Po ashtu, në fq. 4, ku thuhet “kryesuesi Rrusta”, duhet të jetë “drejtori Rrusta”, ka shtuar prof. Shabanaj.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar me vërejtjet nga anëtarë Shabanaj.

**Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar me vërejtjet.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit të Menaxhimit Financiar të Komunës për periudhën janar – qershori 2017.**

Kryesuesi fjalën për raportim e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH-it, Ramiz Rrusta.

**Ramiz Rrusta**, në mënyrë kronologjike raportoi rreth Raportit të Menaxhimit Financiar të Komunës për periudhën janar – qershori 2017.

“Materialin e keni marrë me kohë. Përpara i keni parametrat e gjashtë mujorit të parë për këtë vit. Ndryshimi në këtë periudhë krahasuar me vitin e kaluar është më i lartë për 3.64 pind. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – qershori 2017 në vlerë 3,849,907.46 € është 42.51 % e buxhetit në SIMFK për gjashtëmujorin 2017. Nga Granti qeveritar 3,652,572.65 € (47.96 % në raport me buxhetin nga Granti ), nga të hyrat vetanake 117,261.79 € (11.38 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2017 ), nga të hyrat e bartura 26,190.09 € ( 7.97% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga donacioni i Save the Children 4,664.93 € (82.48% në raport me buxhetin nga ky donator ) dhe nga donacioni i Qeverisë Japoneze 49,218.00 € ( 71.14% në raport me buxhetin nga ky donacion ). Ndërsa, nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 3,849,907.46 € nga granti qeveritar janë 94.87% , nga të hyrat vetanake 3.05 % , nga të hyrat e bartura 0.68 % , nga donacioni i Save the Children 0.12% dhe nga donacioni i Qeverisë Japoneze 1.28 %. Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 3.75 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga buxheti i shpenzuar në përudhen janar – qershori 2017 në vlerë 3,849,907.46,€ për paga dhe, mëditje janë shpenzuar 2,829,327.51 € ( 73.49% e shpenzimeve ), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 273,692.66,€ ( 7.11% e shpenzimeve ), për shërbime komunale 8,430.91 € ( 2.09% e shpenzimeve ), për subvencione 45,279.20 ,€ ( 1.18 % e shpenzimeve ) dhe për kapitale 621,177.18 € ( 16.13 % e shpenzimeve ). Shpenzimet në periudhën janar-qershori 2017 në vlerë 3,849,907.46 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në vlerë 3,710,766.01 € janë rritë për rreth 3.75 %. Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogëluar 0.11 % , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 9.77 %, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për 9.32 % , shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 2.08 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritë për rreth 41.20 %. Totali i përgjithshëm është 3,849,907.46 euro”, theksoi drejtori Rrusta, i cili në vijim sqaroi edhe shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë rreth raportit. “Këtu sot kam sjellë edhe raportin e subvencioneve, nga kanë shkuar mjetet të dedikuara për subvencione. Te

krahasimi i të hyrave eventuale e kem i një krahasim të tillë. Jemi të gatshëm t'ju përgjigjemi pyetjeve tuaja”, pohoi ndër të tjera drejtori Rrusta.

**Fadil Gashi**, tha se është një mangësi me e krahasuar me të kaluarën. “Te shpenzimet nuk është bërë krahasimi me vitin 2016. Të na sqarohet te subvencionet dhe transeret. Vetura, a është fjala për veturën e kryetarit, apo për cilën bëhet fjalë”, tha anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, kërkoi sqarim rreth autoambulancës së QKMF-së, po ashtu ngrehu edhe disa çështje tjera rreth shpenzimeve. .

**Ramiz Rrusta**, sqaroi interesimet e anëtarëve Gashi dhe Merturi. “Në AK mund t'ju sjelli shifrat e shpenzimeve për subvencione etj. “Mirëmbajtje e veturave zyrtare dhe e ndihmës së shpejtë”, do t'ju sjelli specifikacionet. “Furnizim për zyra”, i kemi për secilën drejtori. Nuk do të bëhem avokat i asnjës drejtorie. Ata e menaxhojnë buxhetin e tyre. Në AK do t'u përgjigjem anëtarëve të KK-së”, ka pohuar drejtori Rrusta.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për shqyrtim dhe miratim në seancën e rashës të KK-së.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

**Pika e katërt: Shqyrtimi i Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së Tatimit në pronën e Paluajtshme.**

**Haxhi Ibishi**, tha se janë kaluar të gjitha fazat., ka qenë edhe në debat me publikun. E keni procesverbalin”, shtoi kryesuesi.

Kryesuesi hapi debatin.

**Skënder Merturi**, tha se janë 3 përshkallëzime, të bëhen 4, pra të kihet parasysh, le të shtohet edhe zona 4. “Të bëhet kërkësë që kur të nxirret ligji që dënimet të mos aplikohen për vitin vijues. KK të marr vendim për lirimin e taksave të bizneseve që janë prekur nga punimet e sheshit, përjashtuar KEK-un, bankat dhe postën”, tha anëtari Merturi.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së Tatimit në Pronën e Paluajtshme.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi për seancën e KK-së.**

**Pika e pestë: Shqyrtimi i propozimit për vënien në diskutim publik të Projekt-rregullores për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.**

**Kryesuesi Ibishi foli rrëth çështjes në rend të ditës. Hapi debatin.**

**Fadil Gashi**, foli rrëth çështjes në debat. Anëtari Gashi prezantoi vërejtjen pse mungon materiali i kësaj projekt-rregulloreje. “Arsyeja jonë pse nuk mund ta votojmë është pse nuk kemi material?! Është rregullore jashtëzakonisht e ndjeshme për qytetarët e Klinës. Për shkak të rëndësisë që ka ky dokument nuk mund të votojmë përmendsh. Nuk jemi kundër rregullores, por mënyrës se procedimit të saj”, theksoi anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin për vënien e diskutim publik të Projekt-rregullores për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Me 4 vota për, 3 kundër u miratua propozimi për vënien në diskutim publik të Projekt-rregullores për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.**

**Pika e gjashtë: Shqyrtimi i procesverbalit të takimit të parë me qytetarë për vitin 2017.**

Kryesuesi foli rrëth procesverbalit të takimit të parë me qytetarë për vitin 2017.

Hapi debatin rrëth procesverbalit. Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e takimit të parë me qytetarë për vitin 2017.

**Me vota unanime u miratua procesverbali i takimit të parë me qytetarë për vitin 2017.**

**Pika e shtatë: Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Komunës për vitin 2016.**

Kryesuesi, Dr. Ibishi foli rrëth çështjes në rend të ditës në vijim hapi debatin.

**Fadil Gashi**, tha se jam munduar për ta shqyrtuar, mirëpo nuk dallon nga ai paraprak. “Edhe kryetari është pajtuar. E keni thënë që s’kanë ditur, mirëpo e vërteta po del që ata kanë ditur shumë mirë. I kam parë të gjeturat, a ka më absurd 45 cent thesi i miellit, 1 euro kilogrami i kafes!? Atë operator duhet shpallur të papërgjegjshëm. Shuma më e madhe ishte te ndërtimi i sheshit. Dhe vonesa e punimeve, ku si arsyetim merren kushtet atmosferike! Nuk po punohet as ditëve të verës, ja ku i kemi përballë, askush nuk punon.

Me ndryshimin e pushtetit do të ndryshojë edhe qasja. Për dhjetë vjet në komitet të auditimit nuk e kemi formuar, edhe pse është kërkesë”, ka theksuar ndër të tjera anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se të gjeturat janë të shumta. “Disa herë është bastisur Zyra e prokurimit, jo për punë të mirë. Aty ka pasur punë jo të mira. Ky raport e ka vërtetuar se në këtë zyrë bëhen punë jo të mira”, ka konstatuar ndër të tjera anëtari Merturi.


Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin për procedim në seancë të KK. Rekomandimi u miratua.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 10:45 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI



Kryesuesi i KPF-së  
Dr. Haxhi IBISHI

